



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA
MINISTËR SHTETI PËR PUSHTETIN VENDOR
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E VETËQEVERISJEN VENDORE

PROCESVERBALI I MBLEDHJES

**TAKIMI I GRUPIT TEKNIK TË PUNËS SË PERFORMANCËS LIDHUR ME
TREGUESIT E PERFORMANCËS 2024 NË FUSHËN E BUJQËSISË**

Tiranë, 9 Prill 2025

Hapja e mbledhjes

Mbledhjen e hapi z. *Stiljan Llavdaniti, Drejtor i Përgjithshëm i Komanduar, AMVV* duke përshëndetur dhe falenderuar pjesëmarrësit për praninë e tyre. Ai u shpreh se qëllimi kryesor i takimit ishte reflektimi mbi aspektet pozitive të procesit gjatë vitit të kaluar, si dhe identifikimi i dobësive dhe mangësive me qëllim përmirësimin e mëtejshëm. *Z. Llavdaniti* theksoi se mangësitë e konstatuara vitin e kaluar do të adresohen, në mënyrë që procesi të bëhet sa më transparent dhe më i frytshëm.

Çështje të diskutuara

Znj. Olta Caca, Drejtor i Drejtorisë së Statistikës dhe Performancës, AMVV vazhdoi me prezantimin e rezultateve të SMP 2023 në lidhje me fushën e bujqësisë. Disa nga gjetjet kryesore të raportit vjetor ishin:

1. Funksioni i ujitje-kullimit për mirëmbajtjen e kanaleve dytësore/tretësore u transferua në vitin 2016 bashkive;
2. Mirëmbajtja e kanaleve ujitëse rezultoi 23% dhe kanaleve kulluese vetëm 13%;
3. 47% e tokave bujqësore janë të pajisura me infrastrukturë ujitëse dhe kulluese;
4. Në bashkitë e vogla mirëmbajtja në kanalet ujitëse arrin në shkallën 38%, ndërsa në bashkitë më të mëdha, ky tregues bie deri në 12%;
5. Në bashkitë me tokë kryesisht bujqësore, vetëm 15% e kanaleve të ujitjes rezultuan të mirëmbajtura, ndërsa në ato me shumicë pyjesh dhe kullota ky tregues rritet deri në 40%;
6. Terrenet kodrinore, kanë aftësi natyrore për pastrim dhe janë më pak të prirura për t'u bllokuar.

Gjatë procesit të SMP janë konstatuar disa problematika lidhur me të dhënat. Vlera e kanaleve në km e raportuar nga bashkitë nuk përputhet me vlerën e kanaleve në km e marrë nga MBZHR.

Komente:

Znj.Ornela Shapo, Ekspert, Smart Processess thekson se mos-përputhshmëria ndërmjet raportimeve të bashkive dhe MBZHR lidhet me mungesën e hartave shoqëruese gjatë transferimit të kanaleve kulluese. Rrjeti është zgjeruar ndër vite për t'u përshtatur me parcelat më të vogla, ndërsa urbanizimi ka dëmtuar strukturën ekzistuese. Sipas saj, Ministria dispononte një hartë me tre kategori kanalesh (primar, sekondar, terciar), por bashkive iu transferuan vetëm ato sekondare dhe terciare, pa një ndarje të qartë mes tyre, ç'ka ka sjellë paqartësi në administrim. Gjithashtu, vë në dukje dhe problematikën me njësitë matëse të raportuara nga bashkitë (m, km), pohuar kjo edhe nga *Znj. Voltana Ademi, ekspert, Smart Processes*.

Znj.Ademi u shpreh se rrjeti i kanaleve vaditëse paraqet nivelin më të ulët të mirëmbajtjes në krahasim me rrjetet e tjera. *Z. Llavdaniti* vijoi duke sqaruar se Ministria e Bujqësisë ka zbatuar programe vjetore subvencionimi në mbështetje të bashkive, me fokus në rikonstruksionin ose ndërtimin e kanaleve ujitëse, përkatësisht 2016-2024.

Znj.Shapo lidhur me të dhënat theksoi se qëndrimi dhe raportimi i bashkisë për mirëmbajtjen është i konsiderueshëm në momentin që është funksional.

Pas diskutimeve vijuese për këtë pjesë të tematikës, *Znj.Caca* thekson që ky reflektim do të mundësojë përmirësimin e mëtejshëm lidhur me treguesit e performancës për fushën e bujqësisë, duke konsideruar problematikat konkrete. Gjithashtu, u shpreh se ekzistenca e një plani për ujitjen dhe kullimin u evidentua si mangësi gjatë ushtrimit të kaluar. Konsiderohet e rëndësishme të propozohet treguesi “*Përçindja e kanaleve funksionale të ujitjes dhe kullimit*”.

Znj.Valbona Karakaçi, Ekspert, Bashki të Forta u ndal tek aspekti i GBP dhe rëndësia e përfshirjes së treguesve të raportohen dhe të përfshihen në sistem, duke u lidhur me SMP-në në mënyrë të koordinuar. Duhet përfshirë elementët e raportimit ose monitorimit të planit në mënyrë që tranziti i GBP të jetë më efektiv.

Znj. Denalda Kuzumi, Ekspert, Smart Processess theksoi se sektori i bujqësisë përbën një funksion të rëndësishëm për zhvillimin ekonomik vendor, veçanërisht duke pasur parasysh se në të ardhmen pritet që zhvillimi ekonomik të fokusohet kryesisht në bujqësi dhe turizëm. Në këtë kontekst, ajo sugjeroi që planet vendore duhet të reflektojnë këtë orientim dhe se granti bazuar në performancë, gjatë dy viteve të para, mund të mbështetet jo në rezultatet përfundimtare të zbatimit, por në ekzistencën e instrumenteve bazë që mundësojnë matjen e performancës në vazhdim.

Znj. Caca vijoi duke sqaruar se mekanizmi i grantit është konceptuar nga analiza e zhvilluar pas raportit të SMP, duke u bazuar në gjetjet dhe rekomandimet që kanë dalë prej tij.

Znj. Karakaçi shtoi se qasja e grantit është sistematike, pra në parim zbatohet për të gjitha funksionet vendore. Ajo vuri në dukje se, nëse llogaritet që zbatimi i planeve do të matet në vitin 2027 për planet e hartuara në vitin 2025, atëherë është e nevojshme që në SMP të këtij viti të përfshihet një tregues që mat raportimin e planeve të zhvillimit. Kjo do të shërbente për të krijuar një kulturë të raportimit gjatë vitit të parë dhe më pas për të mundësuar monitorimin në vitin pasardhës.

Znj. Caca shprehu rezervën e saj lidhur me sektorin e bujqësisë, duke theksuar se bëhet fjalë për një fushë me rëndësi të madhe dhe potencial të lartë për zhvillimin ekonomik, por që aktualisht përfaqësohet me shumë pak indikatorë. Ajo theksoi gjithashtu se edhe indikatorët ekzistues paraqesin problematika në vetvete. Në këtë drejtim, u shpreh se ekziston mundësia dhe nevoja për të zgjeruar disi gamën e treguesve në këtë fushë.

Z. Llavdaniti për sa më sipër u shpreh se mund të parashikohet një mënyrë incentivimi veçanërisht për bashkitë që kanë fokus në sektorin e bujqësisë. Ai theksoi se kjo mund të shërbejë si një mundësi e mirë për të kompensuar ato raste kur bashkitë nuk kanë arritur të përmbushin objektivat e tyre në këtë fushë.

Znj.Caca vijoi duke sqaruar arsyet pse është menduar që treguesit aktual të mos përfshihen në formën e tyre ekzistuese. Ajo u ndal në rastin e mirëmbajtjes së kanaleve ujitëse dhe kulluese, duke theksuar se, në përgjithësi, ka paqartësi lidhur me përmasën e mirëmbajtjes, fondet e

shpenzuara, si dhe me objektivat përkatëse, të cilat në disa raste janë shumë të kufizuara, ndërsa në raste të tjera mund të jenë të papërcaktuara mirë. U theksua se termi “mirëmbajtje” përdoret më shumë si një terminologji e përgjithshme sesa si një koncept i qartë dhe i matshëm, çka e bën të vështirë identifikimin e cilësisë dhe vlerësimin e saktë të ndërhyrjeve të kryera. *Znj. Caca* parashtroi gjithashtu disa tregues të rinj që propozohet të shtohen, për të adresuar më mirë këtë mangësi dhe për të rritur saktësinë në matjen e performancës në këtë fushë.

Znj. Arta Kodra, Përgjegjës, AKM parashtroi pyetje lidhur me mundësinë e propozuar për një tregues që lidhet me kontrollin dhe monitorimin e cilësisë së ujërave. *Z. Llavdaniti* shprehu mendimin se një tregues i tillë mund të propozohet, por theksoi se duhet të jetë i matshëm dhe i qartë për t’u implementuar me sukses. Ai vijoi duke theksuar se ky është viti i dytë i matjes së performancës, dhe një nga sfidat kryesore mbetet edukimi dhe orientimi i duhur për raportimin e saktë të të dhënave.

Z. Arben Mukaj, Drejtor, MBZHR vijoi duke shpjeguar në terësi sistemin e kanaleve kulluese dhe ujitëse, duke bërë një përshkrim të gjendjes së tyre në të kaluarën, procesit të transferimit të tyre dhe rëndësisë së inventarizimit të pasurive të paluajtshme. Ai vuri në dukje se një pjesë e problematikave aktuale lidhen drejtpërdrejt me ngjarje dhe vendimmarrje të mëparshme në kohë. Ky diskutim nxiti një qasje interaktive ndërmjet pjesëmarrësve, duke sjellë shkëmbim mendimesh dhe reflektime mbi sfidat e tanishme dhe mënyrat e adresimit të tyre.

Përfundime

Në përmbyllje të kësaj pjese, *Z. Llavdaniti* ngriti pyetjen dhe kërkoi dakordësinë e anëtarëve të grupit të punës, lidhur me treguesit e propozuar për SMP 2024, si më poshtë:

- **MBZHR do të sigurojë një listë me 14 tregues, nga e cila do të përzgjidhen treguesit përfundimtarë për SMP.**
- **Përzgjedhja duhet të vijë pas shqyrtimit të indikatorëve dhe të konfirmohen nga MBZHR;**

Të gjithë anëtarët e grupit të punës ranë dakord me propozimin.